



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E PROKURIMIT

Ballsh, më 25.08.2022

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit:

“Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):

45211100-0 Punime ndërtimi për shtëpi

Vlera e fondit limit:

31,242,703 (tridhjetë e njëmilion e dyqind e dyzetë e dymijë e shtatëqind e tre) **Lekë pa TVSH**

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhëri përkatës i prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesë blerjes (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës dhe Lista e Çmimeve sipas Shtojcave 1 dhe 2;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenet 26, 29 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit

pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Raporti pozitiv ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të bilanceve të dy viteve të njëpasnjëshme, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësi/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave

vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

2.3. Kapaciteti teknik:

Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

- **Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:** Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt kolaudim; - Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

- **Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:** Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt kolaudim; -Leje përdorimi; - Faturën/at tatimore të deklaramit të objektit në organet tatimore.

Në rast se oferta paraqitet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 2.3.1, gërma “a”, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1, gërma “b”, duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm, pasi garanton Autoritetin Kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë Licencën profesionale të shoqërise për realizimin e punimeve objekt kontrate, ku duhet të përfshihen kategoritë e mëposhtëme:

NP-3 A (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)

NS-1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

NS-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)

NS-14 A (Impiante të brendshme ekektrike, telefonike, radiotelefoni, TV)

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, ku janë të disiplinuar procedurat përkatëse të licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit. Gjithashtu, kjo kërkesë referohet edhe në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore...”.

Pikat e licencave janë përcaktuar në bazë të zërave të përshkruara në preventivin e projektit.

Niveli i shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi A (edhe për herë të parë) 0 - 20 milion lekë.

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën **30 (tridhjetë) punonjës** të siguruar, **për tre muajt e fundit** nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.*

*Konkretisht, në përcaktimin e numrit të punonjësve janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve, orët e punës, shpërndarja e kantierit të punimeve etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje minimalisht **për tre muajt e fundit**, tregon besueshmërinë e nevojshme për autoritetin kontraktor lidhur me përmbushjen kontratës nga OE. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të Operatorit Ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është detyrim i punëdhënësit sipas parashikimeve të Kodit të Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarëve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat e kualifikimit, përveç besueshmërisë së Operatorëve Ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, dhe njëkohësisht është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës së punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të

vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në licencën dhe listëpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier elektrik

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri dhe formimi profesional i inxhinierëve që përbëjnë stafin kryesor teknik, është përcaktuar duke u nisur nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën **për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave**, minimalisht:

- 2 (dy) muratorë
- 2 (dy) elektrikistë
- 2 (dy) bojaxhinj
- 2 (dy) pllakashtrues
- 2 (dy) karpentierë
- 2 (dy) suvatues

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet: kontrata e punës (e vlefshme), dëshmi/diplomë/certifikatë/trajnim për kualifikimin e kërkuar (e vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për stafin mbështetës të kërkuar në objekt, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Nëpërmjet këtij stafi, synohet realizimi i objektit të kontratës brenda afatit, normave dhe me cilësi sipas standardeve në fuqi. Staf mbështetës është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- 2.3.6.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e punimeve objekt kontrate, si më poshtë:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues 7 – 12 ton	Në pronësi ose me qira	1
2	Kamionçinë deri në 3.5 ton	Në pronësi ose me qira	1
3	Minieskavator	Në pronësi ose me qira	1
4	Betoniere kantieri	Në pronësi ose me qira	3
5	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1
6	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	1
7	Tabela sinjalistike	Në pronësi ose me qira	10

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -certifikata e pronësisë së mjetit; -certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit.
- Ndërsa për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë marrë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë e vlefshme.
- Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë apo qiramarrjen e tyre.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklaratë duhet të përmbajë vendndodhjen e saktë të mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimi.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë minimalisht mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e punimeve, me qëllim për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i mjeteve, makinerive e pajisjeve të cilat duhet të disponohen nga OE në njërin prej formave të kërkuara, janë vlerësuar si të nevojshme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve objekt kontrate. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike sa i përket disponimit të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, e për këtë qëllim janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqiten si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave të përcaktuara. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në përcaktimin e numrit të punonjësve dhe mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e punimeve objekt kontrate, janë marrë në konsideratë përcaktimet e bëra në VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, si dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

2.3.7. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen janë si më poshtë dhe duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente,
- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalente,
- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër të realizojnë sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët ekonomikë si zbatues të punimeve, të kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara, me qëllim për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, janë standarde që çdo subjekt duhet ti përmbushë në veprimtarinë e tij, pasi respektimi dhe ushrimi i veprimtarisë në përputhje me këto standarde, përveçse ndikon në arritjen e suksesit të subjektit, është njëkohësisht edhe një indikator që tregon besueshmëri për realizimin e punimeve në harmoni me standardet e cilësisë e duke mbajtur në vëmendje edhe kujdesin që duhet treguar për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit e sigurisë në punë. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Pra, nisur edhe nga vetë përcaktimi ligjor, kërkesat e përcaktuara sipas kësaj pike, janë në përputhje dhe harmoni me natyrën dhe përmasat e objektit që prokurohet.*

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet Teknike për procedurën objekt prokurimi, janë hartuar nga DAZHTK, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Mallakastër, që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke qenë element përbërës i tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të ligjit nr.9290, datë 07.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, i ndryshuar dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, si dhe kërkesat e ligjit nr.10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

Fondi limit i përllogaritur, është hartuar në bazë të VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Grafiku i zbatimit të punimeve është parashikuar për një periudhë 6 (gjashtë) mujore.

Shënim: Në dokumentacionin teknik (preventiv, specifikime teknike, etj) të procedurës objekt prokurimi, për çdo material/mall/prodakt për të cilin është specifikuar fjala “importi”, pranohet edhe “ekuivalenti” i tij.

Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden bashkëngjitur DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në zbatim të nenit 56, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, formulari i njoftimit të kontratës dhe dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi, do të ngarkohen dhe dërgohen për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe buletin e njoftimeve publike.

Bazuar në nenin 42, pika 5, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, afati kohor për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.

Duke qenë se kjo procedurë prokurimi zhvillohet me mjete elektronike, shihet e arsyeshme që afati për pranimin e ofertave të shkurtohet me 5 ditë. Shpallja e njoftimit të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem. Në këtë kuptim, duke qenë se dita e fundit e përfundimit të afatit të shkurtuar takon në ditë pushimi javor, afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave do të jetë:

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data 12.09.2022, ora 10:00, prokurim elektronik në adresën www.app.gov.al

Kërkesat e veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, janë hartuar dhe argumentuar nga z. (Ing. Ndërtimi - specialist i fushës në urdhërin e prokurimit), sipas procesverbalit të

datës2022 “Mbi hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, për procedurën e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara”, procesverbal i cili administrohet në dosje. Kërkesat e veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, pasqyrohen në shtojcën 7 të dokumentave standarte të tenderit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2.3. “Kapaciteti teknik”, nënpikat 2.3.1. – 2.3.7.

Personi i autorizuar për kryerjen e veprimeve në SPE:

Për këtë procedurë, Njësia e Prokurimit autorizon z. për ngarkimin e dokumentacionit dhe kryerjen e veprimeve procedurale në sistemin e prokurimit elektronik.

Në përfundim anëtarët e Njesisë së Prokurimit nënshkruajnë këtë procesverbal i cili përbëhet nga 12 (dymbëdhjetë) fletë dhe administrohet në dosjen e prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT